




Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna Junik – Opština Junik– Municipality Of Junik



DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE INSPEKSION MBROJTJE DHE SHPËTIM

RREGULLORE

MBI ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT RRUGOR LOKAL BRENDA TERRITORIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT

Maj, 2015

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika “c”, nenit 17 pika “f” dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika “a” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, të nenit 10 pika “f”, nenit 21 pika d, dhe nenit 22, paragrafit 22.1 pika 3 të Statutit të Komunës së Junikut nr.001/ 3127 të datës 30.09.2010, nenit 6 të Ligjit për transport rrugor, Nr. 04/L-179, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.05.2015, miratoi:

RREGULLOREN KOMUNALE MBI ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT RRUGOR LOKAL BRENDA TERRITORIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT

Neni 1

I. Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi:

1. Caktimi i parimeve dhe rregullave me të cilat përcaktohen kushtet dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë së sektorit të transportit në qarkullimin rrugor urban dhe urbano-periferik;
2. Krijimi i parakushteve për rregullimin e transportit të udhëtarëve me: Auto-Taxi 4 +1 ulëse dhe Automjetet me mbi (8+1) deri në (17+1) ulëse, brenda territorit të Komunës së Junikut;
3. Sigurimi i ofrimit të shërbimeve të transportit rrugor brenda territorit të Komunës;
4. Krijimi dhe mbështetja e konkurrencës në mes të operatorëve të transportit dhe mbështetjen e interesave të udhëtarëve.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. Ministria - Ministria përkatëse për transport;

1.2. Komunë - njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Ligjit përkatës për Vetëqeverisjen Lokale;

1.3. Drejtoria - Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim në K. Junik;

1.4. Transport publik - transport të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit;

1.5. Rrugë publike - një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;

1.6. Operator-taksi - veprimtari e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik;

1.7. Itinerar - akti i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;

1.8. Certifikatë e automjetit - dokument të cilin e lëshon organi kompetent për çdo automjet veç e veç dhe i cili përmban të dhënat për: lëshuesin e organit kompetent, operatorin e transportit,

numrin e licencës, përkatësisht lejes, shenjën (targat) e regjistrimit, markën tipin, numrin e shasisë së automjetit, kapacitetin bartës, llojin e transportit që mund të kryhet, datën e lëshimit të certifikatës, vulën dhe nënshkrimin;

1.9. Licencë - akti me të cilin operatori i transportit rrugor lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave,

1.10. Transport publik linjor i udhëtarëve - transporti i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht;

1.11. Linjë - relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;

1.12. Linjë urbane - linja e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune - qyteti;

1.13. Linjë urbane-periferike - linjë e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit të një Komune;

1.14. Linjë udhëtarësh - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve me ndalje të detyrueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit;

1.15. Linjë direkt - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljes së autobusëve, e përcaktuar në rend të udhëtimit pa u ndalur nëpër vend ndalje përgjatë rrugës;

1.16. Linjë ekspres - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve të përcaktuara në rend të udhëtimit duke u ndalur edhe në ndonjë stacion të rëndësishëm të autobusëve, përkatësisht në vend ndalje të autobusëve të përcaktuara në rend të udhëtimit;

1.17. Udhëtar - personi / personat fizik të cilët transporton nga operatorët e transportit rrugor me kompensim dhe i cili në bazë të kontratës ka të drejtë transporti;

1.18. Transport i veçantë linjor - transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositësit të transportit, me çrast transportin e paguan porositësi;

1.19. Transport në komunikacionin rrugor - çdo transport të udhëtarëve ose të mallrave, duke përfshirë edhe ngasjen e automjetit të zbrazët ose të pangarkuar;

1.20. Transport i lirë i rastit i udhëtarëve në komunikacionin rrugor - transport me të cilin një grup paraprakisht i caktuar i udhëtarëve transportohet sipas kushteve që janë dakorduar me kontratën ndërmjet operatorit të transportit dhe porositësit të transportit e i cili nuk është transport

linjor publik, transport i veçantë linjor, transport i lirë i kohëpaskohshëm;

1.21. Transport i lirë vajtje-ardhje udhëtarëve në komunikacionin rrugor - transportin me anë të cilit, me një varg udhëtimesth të nisjes dhe të kthimit grupet e udhëtarëve të formuara paraprakisht transportohen nga e njëjta vendndisje deri në të njëjtin vend të destinacionit. Secili grup i cili ka kryer udhëtimin në nisje, kthehet në vend nisje me të njëjtën ose me udhëtimet e mëvonshme të të njëjtit operator të transportit;

1.22. Transport për nevoja vetanake - transport i personave ose të mallrave të cilin e kryejnë pa kompensim personat fizikë ose juridikë, për t'i plotësuar nevojat e prodhimit ose të shërbimeve në kuadër të veprimtarive të veta;

1.23. Transport për palë të tretë - transportin e mallrave me automjet transportues apo tërësi të mjeteve të transportit të kryer me qëllime komerciale për personat tjerë fizik dhe juridik;

1.24. Operator i Transportit - personi fizik ose juridik, vendor ose të jashtëm i cili posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së transportit në komunikacionin rrugor;

1.25. Fletudhëtim - formularin e përcaktuar të cilin operatori i transportit duhet ta ketë gjatë kryerjes së transportit rrugor të lirë të udhëtarëve në transportin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar;

1.26. Flet urdhëresë e rrugës - formular i përcaktuar i cili përmban numrin e regjistrimit të autobusit me të cilin kryhet transporti linjor i udhëtarëve, emërtimin e linjës, kohën e fillimit dhe të mbarimit të udhëtimit, të dhënat për personelin e automjetit dhe drejtimin e qarkullimit të tij, nënshkrimin e personit të autorizuar për lëshimin e fletë urdhëresës së rrugës si dhe rubrikën për shënimin e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve ose nga vend ndalja e autobusëve në transportin linjor;

1.27. Relacion - distancë ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve;

1.28. Tërësi e mjeteve të transportit - kombinim i një mjeti tërheqës edhe të paktën një rimorkio ose gjysmë rimorkio;

1.29. Ngasës - person që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e automjetit transportues;

1.30. Rendi i udhëtimit - akt i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vend ndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën brenda të cilës mbahet linja dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit;

1.31. Tarifë - akt i cili përmban çmimin lidhur me kryerjen e shërbimeve dhe kushteve tjera transportuese;

1.32. Aparat i kontrollit - tahografi - aparati i destinuar që të jetë i instaluar brenda automjetit për të treguar dhe regjistruar në mënyrë automatike apo gjysmë automatike të dhënat mbi rrugëtimin e këtyre automjeteve dhe mbi disa, kohën e punës të ngasësve të tyre;

1.33. Fletë incizim - fletë e përpiluar për të pranuar dhe shënuar incizimet, për ti vendosur në aparatin e kontrollit dhe në të cilin mekanizmi i shtypësit (printerit) i përshkruan në vazhdimësi diagramet e të dhënave të regjistruara;

1.34. “Leje” dokumenti me të cilën lejohet kryerja e transportit urban, urbano-periferik të udhëtarëve dhe transportit “taxi”;

1.35. “Auto-Taksi” nënkupton veprimtarin e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik i cili kryhet me automjet me 4+1 ulëse dhe i cili ka së paku 4 dyer;

1.36. “Autobusi” nënkupton veprimtarin e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik i cili kryhet me automjet me mbi (8+1) deri në (17+1) ulëse.

Neni 3

1. Kuvendi i Komunës së Junikut (në vazhdim “Kuvendi”), me propozim të drejtorisë:

1.1. përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit të sigurt, efikas dhe ekonomik brenda territorit të komunës;

1.2. nxjerr planin e transportit dhe e ndryshon atë sipas nevojës;

1.3. ndryshon planin e transportit, jo më vonë se pesë vjet nga data e nxjerrjes së tij;

1.4. publikon planin, apo planin e ndryshuar, dhe një kopje të tij ia dërgon Ministris kompetente për transport rrugor (në vazhdim “Ministria”);

1.5. komuna mund të nxjerr akte administrative përmes të cilave cakton rregullat lidhur me operimin e operatorëve, me kusht që këto rregulla të mos dëmtojnë të drejtat dhe intereset e asnjëres prej bashkësive.

2. Plani duhet të jetë në përputhje me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë.

Neni 4

E drejte për operim

Të drejtë operimi në transportin urban dhe urbano-periferik brenda territorit të Komunës kanë vetëm operatorët e licencuar nga Komuna, gjegjësisht Ministria.

Neni 5

Licencimi

1. Kushtet për licencimin e operatorëve në transportin urban:

1.1. të ketë të regjistruar biznesin në Kosovë (të ketë shifrën përkatëse të veprimtarisë për transportin rrugorë të udhëtarëve);

1.2. dëshminë që ka në pronë ose me qira zyrën administrative;

1.3. dëshminë e lëshuar nga Gjykata se menaxheri i operatorit nuk ka pengesa ligjore të zhvilloj

veprimtarinë në lëmin e transportit;

1.5. dëshminë e lëshuar nga ATK që operatori nuk ka pengesa të natyrës administrative fiskale;

1.6. dëshminë që i ka të kryera obligimet tatimore komunale;

1.7. të posedoi në pronësi së paku një (1) autobus të destinimit urban;

1.8. certifikatën e kontrollimit teknik jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;

1.9. autobusët duhet të jenë të shënuar në të dy anët me mbishkrimin e emrit të firmës (shkronjat me madhësi mbi 20 cm).

2. Kushtet për licencimin e operatorëve në transportin urbano-periferik:

2.1. të ketë të regjistruar biznesin në Kosovë (të ketë shifrën përkatëse të veprimtarisë për transportin rrugorë të udhëtarve);

2.2. dëshminë që ka në pronë ose me qira zyrën administrative;

2.3. dëshminë e lëshuar nga Gjykata se menaxheri i operatorit nuk ka pengesa ligjore të zhvilloj veprimtarinë në lëmin e transportit;

2.4. dëshminë e lëshuar nga Gjykata se operatori nuk ka pengesa ligjore të zhvilloj veprimtarinë në lëmin e transportit;

2.5. dëshminë e lëshuar nga ATK që operatori nuk ka pengesa të natyrës administrative fiskale;

2.6. dëshminë që i ka të kryera obligimet tatimore komunale ;

2.7. të posedoi në pronësi së paku një (1) autobus;

2.8. certifikatën e kontrollimit teknik jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;

2.9. autobusët duhet të jenë të shënuar në të dy anët me mbishkrimin e emrit të firmës (shkronjat me madhësi mbi 20 cm).

3. Aplikacioni i pregaditur nga drejtoria duhet të jetë i nënshkruar nga menaxheri i operatorit dhe të posedoi vulën e operatorit, si dhe dokumentacioni të dorëzohet në origjinal apo kopje e noterizuar .

Neni 6

Certifikata e autobusit

1.Me rastin e aplikimit për pajisje me certifikat të autobusit, operatori duhet të bashkangjesë dokumentacionin:

1.1. kopja e licencës të lëshuar në komuna/ministria;

1.2. kopja e librezës së autobusit;

1.3. kopja e policës së sigurimit;

1.4. kopja e kartonit të kontrollës teknike.

2. Aplikacioni i pregaditur nga drejtoria duhet të jetë i nënshkruar nga menaxheri i operatorit dhe i vulosur me vulën e operatorit, nderësa dokumentacioni duhet të jetë kopje e noterizuar.

Neni 7

1.Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e komunës, janë të detyruar:

1.1. të përdorin mjete të transportit, që janë teknikisht në gjendje të rregullt;

1.2. të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentët për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese;

1.3. të plotësojnë evidenca statistikore, sipas formave të miratuara nga organet përkatëse

- dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- 1.4. të mbajnë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.

Neni 8

Operatori i transportit, i cili bën transportin e rregullt publik, duhet të marrë përsipër transportin e çdo udhëtari apo malli, të cilët nuk janë të përjashtuar nga transporti sipas rregullave të veçanta.

Neni 9

1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, kryhet në bazë të lejes së punës dhe licencës.

1.1. lejet e punës ipen kundrejt pagesës.

1.2. tarifat për regjistrim dhe vazhdim të vijave të udhëtimit për Autobus dhe Auto –Taxi do të jenë:

1.2.1. për regjistrim fillestar brenda territorit të Komunës së Junikut në vlerë prej 50 €;

1.2.2. për vazhdim të rendit të udhëtimit në K.Junik (për tri vite) në vlerë prej 45 €.

Neni 10

1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve nuk mund të ushtrojë veprimtarinë para se të pajiset me licencë, leje dhe rend të udhëtimit.
2. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj si vijon:

1.1. transport i rregullt i udhëtarëve me autobus;

1.2. transport i lirë i udhëtarëve me autobus;

1.3. transport taksi i udhëtarëve;

1.4. transport i udhëtarëve për nevoja vetanake.

3. Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e Forcë së Sigurisë së Kosovës, Forcave të armatosuar ndërkombëtare (KFOR-in), Policinë e Kosovës, Ndihmës së shpejtë, të Zjarrfikësve, Institucioneve publike, Njësitë e Shpëtimit dhe Automjetet me peshë deri në 3.5 ton, apo pesha e përgjithshme nuk i tejkalon gjashtë (6) ton.

Neni 11

II. Transporti rrugor i udhëtarëve

1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e Komunës ushtrohet si:

1.1. transport urban i rregullt i udhëtarëve me autobusë;

1.2. transport urbano-periferik i rregullt i udhëtarëve me autobusë;

1.3. transport i lirë i udhëtarëve;

1.4. transport taksi i udhëtarëve;

1.5. transport për nevoja vetanake.

2. Drejtoria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban dhe urbano-periferik të rregullt të udhëtarëve me autobusë dhe transportin auto-taksi të udhëtarëve.

Neni 12

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.
2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja Komunale.

Neni 13

1. Rrjetin e linjave urbane dhe urbano-periferike e pregaditë drejtoria.
2. Rrjeti i linjave është i plotëfuqishëm pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
3. Rrjeti i lijave përmbanë : Vendin e nisjes, vendin e arritjes, kohën e nisjes, kohën e kthimit dhe kohën mbrojtëse mes nisjeve.
4. Komuna bënë vazhdimin e rendeve të udhëtimit, gjegjësisht shpallë nisje të lira bazuar në rrjetin e linjave të nënshkruar nga Kryetari.
5. Komuna, përmes Kryetarit të Komunës, mund të lidhë marrëveshje me Komunat e tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja është e plotëfuqishme nëse miratohet nga Ministria.

Neni 14

Rendi i udhëtimit

1. Me rendin e udhëtimit përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor në territorin e Komunës i cili përmban:
 - 1.1. emrin e operatorit;
 - 1.2. relacionin;
 - 1.3. llojin e transportit;
 - 1.4. radhitjen e vend ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare në km;
 - 1.5. kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend ndalje;
 - 1.7. ditët e operimit, periudha kohore në të cilën mbahet linja;
 - 1.8. afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
2. Rendi i udhëtimit vlen tre (3) vite.

Neni 15

Operatori Transportues është i obliguar që transportin ta kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar në drejtori.

Neni 16

Pajisja me rendë të udhëtimit

1. Me rend të udhëtimit pajisen operatorët transportues të cilët plotësojnë kushtet si në vijim :
 - 1.1. posedojnë licencën e lëshuar nga komuna/ministria;
 - 1.2. posedojnë kapacitet e nevojshme teknike (autobusët e certifikuara nga komuna/ministria) për numrin e nisjesve që posedon përfshirë edhe nisjen/nisjet për të cilat ka aplikuar ;
 - 1.3. dëshminë e lëshuar nga ATK që operatori nuk ka pengesa të natyrës administrative fiskale;
 - 1.4. dëshminë që keni të kryera obligimet tatimore komunale;
 - 1.5. posedon se paku një (1) shofer për tri (3) nisje.
2. Aplikacioni i përgatitur nga drejtoria duhet të jetë i nënshkruar nga menaxheri i operatorit dhe të

posedoi vulën e operatorit, si dhe dokumentacioni të dorëzohet në origjinal apo kopje e noterizuar.

Neni 17

Vazhdimi i rendeve të udhëtimit

1. Operatori duhet që të aplikoi për vazhdimin e rendit të udhëtimit se paku 30 dit para skadimit të rendit të udhëtimit.
2. Kushtet për aplikim për vazhdimin e rendit të udhëtimit janë të njëjta si në **nenin 16 (për pajisjen me rend të udhëtimit)**, por të njëjtës duhet bashkangjitur rendin e udhëtimit origjinal të lëshuar nga komuna.
3. Aplikacioni i përgatitur nga drejtoria për vazhdimin e rendeve të udhëtimit duhet të jetë i nënshkruar nga menaxheri i operatorit dhe të posedoi vulën e operatorit, si dhe dokumentacioni të dorëzohet në origjinal apo kopje e noterizuar.

Neni 18

1. Operatori Transportues obligohet që ta fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt urban të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpresë derisa të zgjatë afati i rendit të udhëtimit.
2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi mund të ndërpresë përkohësisht veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme, të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban.
3. Për ndërprerjen e veprimtarisë, nga paragrafi 2 i këtij neni, Operatori transportues është i obliguar që të bëjë kërkesë në drejtori, e cila do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së Operatorit transportues.
4. Operatori Transportues nuk mund ta ndërpresë (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në linjë, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar pa lejen e drejtorisë.

Neni 19

1. Operatori Transportues rendin e udhëtimit nuk mund ta tjetërsojë, e as ta japë me qira.
2. Transferimin e rendit të udhëtimit e bën vetëm drejtoria përkatëse.
3. Emri i Operatorit transportues, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të automjetit transportues dhe në dokumentet tjera përcjellëse të automjetit transportues.

Neni 20

1. Drejtoria do të revokojë rendin e udhëtimit në rastet kur:
 - 1.1. në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;
 - 1.2. pa miratimin e Drejtorisë, nuk e bën nisjen 3 herë brenda një muaji kalendarik;
 - 1.3. kur operatori vepron në kundërshtim me ligjin, rregulloren dhe aktet e tjera administrative që i sjell Ministria dhe Drejtoria.
2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

Neni 21

1. Operatori e përcakton çmimoren, e cila duhet të vendoset në automjetin transportues që qarkullon në atë linjë.
2. Personeli i automjetit transportues merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimorës, të cekur në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Ministria me akt nënligjor cakton çmimoren për kategori të veqanta të shoqërisë si për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, studentët, veteranët e luftës, invalidët e luftës dhe të punës.

Neni 22

Biletat

1. Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me biletë në relacion të caktuar:
 - 1.1 Për transportin ndër-urban biletat mund të blihen në autobus dhe stacion të autobusëve.
2. Udhëtari në automjet ka për detyrë të tregojë biletën e udhëtimit me kërkesën e personit të autorizuar nga operatori i transportit, respektivisht nga inspektori i transportit rrugor.
3. Bileta duhet të përmbajë:
 - 3.1. relacionin;
 - 3.2. çmimin me kupon fiskal;
 - 3.3. numrin serik;
 - 3.4. emrin e operatorit të transportit;
 - 3.5. datën dhe kohën e nisjes;
 - 3.6. dëshmi për bagazhin e udhëtarit.

Neni 23

Rregullat e mirësjelljes

1. Anëtarët e ekuipazhit të autobusit me të cilin kryhet transporti rrugor i udhëtarëve dhe personeli i stacioneve të autobusëve duhet të kenë rroba zyrtare (uniform).

Neni 24

Transporti i veçantë i udhëtarëve

1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.
2. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti:
 - 2.1. nxënësve dhe studentëve, nga vendbanimi deri të destinacioni dhe anasjelltas;
 - 2.2. punëtorëve, nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas;
 - 2.3. invalidëve dhe personave me përkujdesje të veçantë.
3. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:
 - 3.1. relacionin;
 - 3.2. listën e udhëtarëve;
 - 3.3. çmimin e transportit;
 - 3.4. vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve;
 - 3.5. kohën gjatë së cilës kryhet transporti.

4. Kontratën për kryerjen e transportit të veçantë e lidh transportuesi, i regjistruar si Operator transporti, dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve.
5. Lejen për transport, sipas këtij neni, e lëshon Drejtoria nëse transporti kryhet brenda një Komune, ndërsa kur transporti kryhet në territorin e dy e më tepër komunave e lëshon Ministria.
6. Në autobus në pjesën e përparme në vend të dukshëm duhet të jetë mbishkrimi “Transport i veçantë”.

Neni 25

Transporti i lire i udhëtarëve

1. Transport i lire i udhëtarëve , në transportin e brendshëm dhe ndërkombëtar është transport i udhëtarëve i krijuar me iniciativ të klientit apo agjensioneve turistike, pa hyrje dhe dalje të udhëtarëve përgjatë rrugëtimit, për të cilin relacioni, çmimi i transportit dhe kushtet e tjera përcaktohen me kontratë ndërmjet operatorit dhe porositësit të transportit.
2. Transporti nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bëhet si vajtje-ardhje dhe i rastit.
 - 2.1. transporti vajtje- ardhje është:
 - 2.1.1. transporti i grupeve të udhëtarëve të organizuara paraprakisht në shumë udhëtime nga vendnisja e njëjtë deri te vendarritja e njëjtë;
 - 2.1.2. çdo grup udhëtarësh i cili ka bërë një udhëtim në shkuarje, kthehet në vendnisje me ndonjë ngasje të më vonshme automjeti;
 - 2.1.3. udhëtimi i parë në kthim dhe i fundit në shkuarje, duhet të bëhet me automjet të zbrazët;
 - 2.1.4 transportet e tjera vajtje-ardhje.
 - 2.2. transport i rastit është:
 - 2.2.1. transporti qarkor me dyer të mbyllura (dalja në piknik, udhëtim turistik etj.), që fillon dhe mbaron në vendnisje, me ç’rast grupi i njëjtë i udhëtarëve transportohet me të njëjtin autobus në mbarë rrugën.

Neni 26

1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti i lirë i udhëtarëve, duhet të jetë regjistri i plotësuar i punëtorëve ose i personave tjerë prezent, i vërtetuar nga pronari (Transportuesi).
2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi “Transport i lirë i udhëtarëve”.

Neni 27

Transporti për nevoja personale

1. Operatori transportues, personi tjetër fizik/juridik dhe qytetari, i cili ka automjetin transportues, mund të kryejë transport për nevoja vetanake dhe transportin e punëtorëve të vet, ose personave të tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.
2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale, në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave, të cilin e bëjnë:
 - 2.1. ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët kryejnë veprimtari hoteliere;
 - 2.2. institucionet shëndetësore dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit;

- 2.3. autoshkollat, të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre;
- 2.4. operatorët transportues ose punëtorët, të cilët kryejnë shërbime të veçanta;
- 2.5. operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit, nëse kryejnë transportin e udhëtarëve nga vendndisja e tyre deri te aeroporti dhe anasjelltas.

Neni 28

1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja personale, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi).
2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi **“Transport për nevoja personale”**.

Neni 29

Transporti “Auto-Taxi”

1. Transporti “Auto-Taxi ” është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit sipas qmimoreve të shërbimeve.
2. Çmimorja duhet të jetë e vërtetuar nga organi kompetent komunal dhe e vendosur në vend të dukshëm brenda automjetit.
3. Taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, i atestuar (bazhdaruar) dhe vëlosur sipas kushteve të përcaktuara për taksi-metër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.
4. Transportuesi që kryen transport “Auto-Taxi ” të udhëtarëve është i obliguar që me kërkesën e udhëtarit, ti jep atij dëshminë për shërbimin e bërë e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, relacionin, kohën e transportit, qmimin dhe nënshkrimin e transportuesit.

Neni 30

1. Transporti “Auto-Taxi” mund të kryhet vetëm me automjetin me 5 (4+1) ulëse, i cili ka së paku katër dyer.
2. Përfshijmish nga paragrafi 1 i këtij neni, Komuna mund të leshoi leje për “Auto-Taxi” me mbi (8+1) ulëse deri në (17+1) ulëse, mirëpo fushëveprimi i këtij lloji ”Auto-Taksi” kryhet vetëm brenda kufijve territorial të Komunës në të cilën ai ka leje për ushtrim të veprimtarisë.
3. Automjeti sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio).
4. Me automjet ”Auto-Taxi” nuk mund të transportohen:
 - 4.1. fëmijët deri në moshën 6 vjeçare pa përcjellës, përveç nëse prindi ose kujdestari me marrëveshje me “Auto-Taxi” (drejtuesin) të njëjtit ia ka besuar fëmijën për bartje deri të vendi i destinuar;
 - 4.2. kufomat;
 - 4.3. kafshët e ngordhura;
 - 4.4. materiet eksplozive, radioaktive, helmuese, që ndizen lehtë, infektive dhe të tjera të cilat për shkak të vetive të veta mund të jenë të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin njerëzve apo mund të shkaktojnë dëme tjera.

Neni 31

1. Personat që drejtojnë automjetin me të cilin kryhet transporti "Auto-Taxi" përpos kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore, dhe ligjit për transport rrugor është e obligueshme të kenë patentë-shoferin me së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit.
2. Personat që drejtojnë automjetin pa leje, apo atyre me afat të skaduar të lejes përkatëse për kryerjen e transportit Auto-Taxi të udhëtarëve, apo shenjë në automjetin "Auto-Taxi" apo shenjë e transportit linjor të udhëtarëve, do të përjashtohen nga trafiku nga ana e inspektorit të trafikut rrugor, do të pasojë marrja e shenjës taksi dhe numri i evidencës së regjistrimit të qarkullimit, si dhe lejen me afat të skaduar.
3. Procesverbali për përjashtimin e automjetit "Auto-Taxi" i dorëzohet drejtuesit aty për aty.
4. Automjetet "Auto-Taxi" që janë të regjistruara për kryerjen e transportit "Auto-Taxi" në territorin e Komunave tjera nuk mund të kryejnë transportin e udhëtarëve në territorin e Komunës së Junikut, vetëm në rast kur sjellin udhëtarë nga komunat e tjera, por që në kthim nuk kanë të drejtë të marrin udhëtarë të tjerë.
5. Numri i udhëtarëve nuk mund të jetë më i madh se sa numri i ulëseve të regjistruara në automjet.

Neni 32

1. Bordi i Drejtorëve me vendim të veçantë përcakton:
 - 1.1. vendqëndrimin për Auto-Taxi, si dhe paisjen e vendqëndrimit me sinjalizim horizontal dhe vertikal;
 - 1.2. përcakton numrin dhe ngjyrën e Auto-Taxi-ve;
 - 1.4. mënyrën e shfrytëzimit të tyre;
 - 1.5. rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre;
 - 1.6. vijat e udhëtimit.
2. Auto-Taxi mund të marrë udhëtarë për transport jashtë vendqëndrimit për "Auto-Taxi", por vetëm me kërkesën e udhëtarit dhe nëse ai e ndalë automjetin në vendin që nuk e pengon qarkullimin e lirë të trafikut.

Neni 33

1. Në vendqëndrimet "taxi" vendosen automjetet "taxi" sipas rendit të ardhjes.
2. Shoferi i TAXI-ve përveq kushtit në paragrafin paraprak duhet ti përmbahet edhe kushteve në vijim:
 - 2.1. Shoferi i TAXI-it është i detyruar të jetë në automjet gjatë kohës derisa gjendet në vendqëndrimin e TAXI-ve.
 - 2.2. Shoferit të TAXI-ve nuk i lejohej të ofrojë shërbime të transportit personal apo edhe nëpërmjet ndërmjetsuesit, dhe transportin ta fillojë jashtë vendqëndrimit të TAXI-ve.
 - 2.3. Shoferi i TAXI-ve nuk mund të marrë udhëtar për transport jashtë vendqëndrimit të TAXI-ve në ato vende ku nuk ndalohet parkingi dhe ndalimi i automjeteve, dhe sipas kërkesës së udhëtarëve.

Neni 34

1. Kushtet për leje të punës "Auto-TAXI" (4+1) (personi fizik):
 - 1.1. të ketë të regjistruar biznesin pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.2. pëlqimin (aktvendimin) e lëshuar nga Drejtoria për plotësimin e kushteve hixheno-teknike;
 - 1.3. të jetë banor i Komunës së Junikut;
 - 1.4. të ketë patentë-shofer, së paku 5 vjet përvojë pune në drejtim të automjetit;

- 1.5. të mos jetë i punësuar te ndonjë punëdhënës tjetër;
- 1.6. të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për “Taxi” drejtues;
- 1.7. të ketë të dhënë provimin profesional para komisionit të themeluar nga organi administrativ kompetent i Drejtorisë (për njohjen e rrugëve në territorin e Komunës së Junikut);
- 1.8. drejtuesi i automjetit të ketë certifikatën mjekësore (jo më të vjetër se 6 muaj);
- 1.9. ngjyra e automjeteve Auto Taxi të përcaktohet nga Drejtoria;
- 1.10. polisën e sigurimit të udhëtarëve;
- 1.11. vjetërsia e automjetit për ushtrim të veprimtarisë mos të jetë më shumë se 10 vite.

Neni 35

1. Automjeti (4+1) duhet t’i plotësojë edhe këto kushte:

- 1.1. t’i ketë së paku katër dyer;
- 1.2. të ketë më së shumti 4+1 ulëse;
- 1.3. të ketë të instaluar taxi-metrin;
- 1.4. të ketë shenjën “Taxi”, të vendosur mbi kulm të automjetit;
- 1.5. çmimorja të jetë e vendosur në automjet ashtu që të jetë e dukshme për udhëtarin;
- 1.6. numri identifikues të jetë i vendosur në automjet në vend të dukshëm;
- 1.7. reklamat e ndryshme, rekomandime dhe shenja tjera nuk lejohet të vendosen mbi sipërfaqen e xhamave;
- 1.8. të posedojë aparatin kundër zjarrit;
- 1.9. Kontrolla teknike e automjetit duhet të bëhet për çdo gjashtë muaj për zhvillim të veprimtarisë “Taxi”.

2. MTI e autorizon ndërmarrjen e specializuar sipas procedurës së paraparë me ligj mbi akordimin dhe rregullimin e taxi-metrin.

3. Drejtoria në rast nevojë mund të përcaktojë kushte të përafërta shtesë (për të gjitha ndryshimet, obliguesit duhet të informohen me kohë).

Neni 36

1. Kushtet për Certifikim të Automjetit më mbi (8+1) ulëse deri në (17+1):

- 1.1. t’i ketë së paku tri dyer;
- 1.2. të ketë mbi 8+1 ulëse deri në (17+1) ulëse;
- 1.3. të jetë i regjistruar dhe siguruar në Kosovë;
- 1.4. çmimorja të jetë e vendosur në automjet ashtu që të jetë e dukshme për udhëtarin;
- 1.5. numri identifikues të jetë i vendosur në automjet në vend të dukshëm;
- 1.6. reklamat e ndryshme, rekomandime dhe shenja tjera nuk lejohet të vendosen mbi sipërfaqen e xhamave, dhe në karoseri të automjetit;
- 1.7. të posedojë aparatin kundër zjarrit;
- 1.8. të posedojë çekanin për thyerje të xhamit në raste të rrezikut;
- 1.9. automjeti të jetë teknikisht në rregull.

Neni 37

1. Gjatë transportit, ndalohet:

- 1.1. pengimi i personelit të automjetit në kryerjen e detyrës;
- 1.2. pirja e duhanit në automjet;
- 1.3. futja e kafshëve në automjet;
- 1.4. hyrja në automjet me armë, përveç personave të autorizuar;
- 1.5. futja në automjet e gjësendeve, të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin;
- 1.6. futja në automjet e materialeve ndezëse dhe e mjeteve eksplozive;
- 1.7. hyrja në automjet në gjendje të dehur;
- 1.8. shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e sjellje të papërgjegjshme;
- 1.9. hedhja e mbeturinave dhe pështymja në automjet;
- 1.10. hyrja në automjet pas vërejtjes së personelit se nuk ka vende të lira.

2. Udhëtari i cili edhe pas vërejtjes, kryen ndonjërin nga veprimet e cekura në nenin 36, largohet nga automjeti.

Neni 38

III. Transportit rrugor i mallrave

1. Transporti rrugor i mallrave në territorin e komunës ushtrohet si:

- 1.1. transporti i mallrave për nevoja personale; dhe
- 1.2. transporti i mallrave me qira dhe pagesë.

2. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:

- 2.1. fletëudhëtimin e nënshkruar nga Menaxheri dhe e vulosur me vulën e operatorit dhe
- 2.2. fleturdhëresën e rrugës (fletëngarkesën).

Neni 39

1. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave.

2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregojë se transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave.

Neni 40

Licenca dhe certifikata e automjetit tërhiqet ose është e pavler në këto raste:

1. Kur vdes ose humb zotësinë për të vepruar mbajtësi i saj:
 - 1.1. personi juridik falimenton ose likuidohet;
 - 1.2. i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;
 - 1.3. në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë:

- 1.3.1. emri i operatorit dhe adresa e selisë;
- 1.3.2. nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
- 1.3.3. data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

2. Zëvendësimi i lejes bëhet me kërkesë të përsoneit fizik apo juridik për rastet kur deklarohet e humbur, e dëmtuar ose ka humbur vlefshmërinë sipas pikës 1.2. të këtij neni.

3. Përsoneit fizik apo juridik që kërkon zëvendësimin e lejes sipas pikës 1.2 të këtij neni, i jepet një autorizim i përkohshëm me afat 1 muaj nga autoriteti kompetent, për vazhdimin e veprimtarisë deri në kryerjen e verifikimeve të nevojshme.

4. Pas kryerjes së verifikimeve, lëshohet leja zëvendësuese me të njëjtën përmbajtje dhe numër të identifikimit.

Neni 41

Sinjalizimi dhe vendparkingjet

- 1. Përgjegjës për rregullimin dhe vendosjen e sinjalizimit vertikal, horizontal, ndriçues si dhe vendparkingjeve dhe vendqëndrimeve në territorin e Komunës së Junikut është Drejtoria.
- 2. Në raste specifike kërkohet pëlqimi i Policisë, përgjegjësve të Trafikut komunal dhe Drejtorisë për urbanizëm,
- 3. Parkingjet e rezervuara të lëshuara nga Drejtoria bëhen kundrejt pagesës ditore e cila do të jetë pjesë përbërëse e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjopa Komunale.
- 4. Parkingjet private duhet të jenë të regjistruara dhe të kenë Aktvendimin për Ushtrim të Veprimtarisë nga Drejtoria.

Neni 42

IV. Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në transportin rrugor urban dhe urbano periferik brenda territorit të komunës, e bënë Drejtoria – Inspektori i Trafikut.

2. Inspektori i trafikut rrugor është i autorizuar brenda territorit të Komunës:

1.1. të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, në bazë të licencave dhe lejeve, të vërtetojë identitetin e operatorit transportues, personelit vozitës dhe të personave të tjerë përgjegjës për kryerjen e transportit;

1.2. të urdhërojë mënjanimin e lëshimeve dhe mungesave në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë rregullore për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave;

1.3. të përjashtojë nga qarkullimi automjetin, me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, të caktojë vendparkimin, t'ia marrë lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh.

3. Nëse të njëjtit operator të transportit i shqiptohet masa e gjobës mandatore për herë të dytë, për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 2, nën-paragrafi 1.2 të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në 5 ditë.

4. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, atij i merret shenja “TAXI” - “RADIO TAXI”, numri i evidencës i regjistrimit të qarkullimit dhe leja për Auto-Taxi.

5. Me kalimin e afatit të masës, nga paragrafi 2, nën-paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 i këtij neni, inspektori ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qoftë vetë apo përmes organit i cili ka lëshuar këto.

Neni 43

1. Kundër vendimit të inspektorit të trafikut rrugor mund të ushtrohet kërkesë për rishqyrtimin e vendimit apo ankesë Ministrisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

2. Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit i dërgohet Drejtorisë, kurse ankesa i dërgohet drejtpërdrejt Ministrisë.

3. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 44

V. Masat Ndërshkuese

Përpos dispozitave ndëshkuese, të parapara me Ligjin e transportit rrugor Nr.04./L 179 të Kuvendit të Kosovës, me datën 16.05.2013, dhe ligjeve tjera të aplikueshme për transport, me këtë rregullore parashihen edhe dispozita ndëshkuese për operatorët që komuna është përgjegjëse për lëshimin e licencave.

Neni 45

1. Operatori i transportit Auto Taxi 4+1 dhe mbi 8+1 deri në (17+1) ulëse dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej 100 deri në 300 €:

1.1. nëse kryen transportin me automjete të cilat nuk i plotësojnë kushtet nga neni 29, 30, 31, 32 dhe 34;

1.2. nëse nuk vepron sipas nenit 35 dhe 36;

1.3. nëse vepron në kundërshtim me nenin 37;

1.4. nëse vepron në kundërshtim me nenin 4, nenin 5, dhe nenin 6;

2. Në rast kundërvajtjeje nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit, me gjobë prej 50 deri në 100 €.

3. Operatori i transportit Auto Taxi 4+1 dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej 50 deri në 100 €:

3.1. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1;

3.2. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 2, nënparagrafët 2.1, 2.2 dhe 2.3;

Neni 46

VI. Dispozitat Kalimtare, Shfuqizuese dhe Përfundimtare

Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë: Drejtoria dhe Policia e Kosovës (Stacioni Policor në Junik).

Neni 47

Për të gjitha qështjet tjera që nuk janë të parapara në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 48

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

Rregullorja mbi transportin rrugor brenda territorit të Komunës së Junikut, të datës 31.05.2010, si dhe pika 18 (Caktimi i gjobave në trafik brenda kufijve të komunës së Juniku) e **Rregullorës për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale** nr.0011169 e datës 27.03.2009.

Neni 49

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në faqen zyrtare (Web-Faqen) të Komunës.

Junik, 29.05.2015

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj


kryesues